



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:260846

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07026001

C.nr.2731/21

GJYKATA THEMELORE NË P. – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. Sh., nga P,të cilin e përfaqëson Heset Mazrekaj avokat në Prishtinë, kundër të paditurit A. L. nga Peja Rr. "A. P.T." pa nr., të cilin e përfaqëson Haxhë Nikqi, avokat në P., me objekt të kontestit, dorëzim paluajtshmërie, vlera e kontestit 500 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik e në prezencën e paditësit të autorizuarit të tij, dhe të paditurit me të autorizuarin e tij, me datën 17.03.2025 mori kurse me datën 21.03.2025 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh. nga Peja kundër të paditurit A. L. nga Peja.

II. DETYROHET i padituri A.L. nga P,që paditësit Sh. Sh. nga P,të i'a lirojë paditësit nga njerëzit dhe sendet pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1-91 ZK P. në sipërfaqe prej 4 m², e cila realizohet nga pika 1 e deri në pikën A në gjerësi prej 0.45 cm që shkon në drejtim të jugut e deri në pikën numër 2 dhe atë me gjatësi prej D-16.98 metra, Gjerësia në drejtim të jugut shkon duke u zbritur dhe varion prej 0.30 cm, 0.10 cm, deri 00 në pikën numër 2, e në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET i padituri A.L.nga P,që paditësit Sh Sh. nga P,të i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 803 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

Arsyetim

I. Historiku i procedurës:

Paditësi Sh. Sh. nga P, të cilin e përfaqëson Hestet Mazrekaj avokat në Prishtinë, kundër të paditurit A.L. nga Peja Rr. "A. P. Tepelena" pa nr., të cilin e përfaqëson Haxhë Nikqi, avokat në P., me datën 19.11.2021 ka ngritur padi me objekt të kontestit dorëzim paluajtshmërie, vlera e kontestit 500 euro.

I autorizuari i të paditurit, me anë të parashtresës së datës 21.02.2025, gjykatës i ka propozuar që të bëhet bashkimi i lëndëve C.nr.2731.21 me lëndën C.nr.299/25, të cilin propozim, gjykata e ka refuzuar me aktvendimin në procesverbalin e datës 17.03.2025, pasi që ka marrë mendimin e palës paditëse, e këtë konform nenit 408.3 të LPK-së. Gjykata një propozim të tillë e ka refuzuar nga shkak se sipas dispozitës së cekur kërkohet pëlqimi i palës kundërshtare dhe kjo është një dispozitë ligjore imperative dhe e pa tejkaloeshme për gjykatën, e si rrjedhojë e kësaj, gjykata nuk mundet që të tejkalojë këtë dispozitë dhe të vendosë ndryshe.

I autorizuari i palës paditëse drejtpërsëdrejti në procesverbalin e datës 17.03.2025, ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë në aspektin objektiv dhe ndryshimin – zmadhimin e kërkesëpadsisë, ku gjykata në seancën e datës 17.03.2025 me aktvendim procedural e ka lejuar precizimin e kërkesëpadsisë në aspektin objektiv sa i përket pikës I të petitimit që ka të bëjë me dorëzimin e paluajtshmerisë, ndërsa sa i përket pikës II që ka të bëjë me ndryshimin-zmadhimin e kërkesëpadsisë për dëm material dhe jo material të njejtën gjykata e ka refuzuar, e pasi që për këtë është marrë edhe mendimi i palës së paditur, i cili e ka kundërshtuar zmadhimin e kërkesëpadsisë. Po ashtu, një gjë të tillë e ka refuzuar edhe nga shkak se paditësi që nga fillimi i shqyrtimit ka mundur që të paraqesë një kërkesë të tillë, kurse ndryshimi i kërkesëpadsisë ka ardhë në një fazë të vonshme të procedurës. Në një rast të tillë, gjykata kishte parasysh dhe nenin 10 të LPK-së.

II. Pretendimet e ndërgjyqësve:

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në padi ka theksuar se pala e paditur A. (Q..)L. nga P, në kundërshtim me normat e nenit 80 par.1 pika 1 të LPDTS-së, pa bashkëpunim e as pa dijenin e paditësit i ka përkufizuar me mur ndarës, NK nr.1-97 lista detale nr.6 ZK P. dhe NK P-1611071-91 ZK P., me ç'rast arsyeshëm besoj se i padituri e ka uzurpuar edhe një pjesë të palujashmerisë

së paditësit të evidentuar si NK P-71611071-91 ZK P.. Tutje ka shtuar se paditësi në cilësinë e fqinjtit të palujatshmerisë, në të cilën i është ndërtuar muri ndarës i palujatshmerive, kërkon që ndërtuesi të mënjanojë pjesën e murit ndarës të pronave, i cili gjendet në palujtshmerinë e paditësit – fqinjtit e cili e kundërshton ndërtimin e të njëjtit. Pas kësaj pronaret e palujatshmerive, në bashkëveprim t’i caktojnë shenjat e përhershme të kufirit, respektivisht vendosjen e shenjave të përhershme në mes të palujatshmerive e pastaj në kuptim të normave pozitive të Republikës së Kosovës, sipas nevojës të të ndërtohet edhe muri përkufizues i palujatshmerive të palëve ndërgjyqëse në cilësi të fqinjëve, duke i respektuar dispozitat relevante të Ligjit për Kadastrin (neni 79 LPDTS). Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve të paraqitura në kërkesëpadi për faktin se i padituri në kundërshtim me normat e neni 80 par.1 pika 1 të LPDTS pa bashkëpunim dhe pa dijeninë e paditësit e ka përkufizuar me mur ndarës njësinë kadastrale numër 1/97 lista detale numër 6 ZK P. njësia kadastrale P-71611071-91 ZK P. me ç’rast paditësi arsyeshëm paditësi beson se i padituri i’a ka uzurpuar një pjesë të palujatshmerisë të evidentuar me nr.njësie të lartcekur. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë pretendimeve të padisë përfshirë edhe pretendimet e dërguara gjykatës lëndore duke shtuar se paditësi në cilësi të fqinjtit së palujatshmerisë lëndore është pronar legal ndërsa i padituri i cili e ka ndërtuar murin ndarës në mes të palujatshmerive të njëjtin e ka ndërtuar në kundërshtim me normat pozitive gjegjësisht të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, rrethane e cila në mënyrë profesionale është konsistuar edhe nga eksperti i fushës përkatëse. Tutje ka shtuar se nga kjo që u tha pala paditëse kërkon nga e paditura që në funksion të eliminimi të parregullsive të mënjanojë rrënojën, pjesën e murit ndarës të pronave i cili është ndërtuar në palujtshmerinë e paditësit – fqinjë i cili vazhdon për të kundërshtuar dhe kërkon eliminim e kësaj parregullsie, ashtu që pas kësaj pronaret e të dy palujatshmerive në bashkëveprim konform normave pozitive ti caktojnë shenjat e përhershme të kufirit në kuptim të normave lëndore sipas nevojës dhe të ndërtojnë bashkërisht murin përkufizues. Andaj bazuar në të lartcekurat gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të lexuara e të pa konstatuara nga ndërgjyqësit të marr aktgjykim si në precizimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në lartësi prej 1,105 euro.

I padituri përmes të autorizuarit të tij, në përgjigje në padi ka deklaruar se fillimisht vlen të theksohet se padia e paditësit është e paqartë, e pa kuptimit, konfuze dhe e pa bazuar, sepse asnjë pretendim që rezulton nga referati i padisë nuk bazohet në prova materiale, apo të ndonjë prove të natyrës tjetër provuese. Kësisoj nga pasuesi i parë i referatit të padisë rrjedh se kinse i padituri në kundërshtim me nenin 80 par.1 të LPDTS, pa bashkëpunim me paditësin si dhe pa dijeninë e

tij: “i ka përkufizuar me mur ndarës NK nr.1/97, lista detale nr.6 ZK P. dhe NK P-71611071-91 ZK P., me ç ‘rast arsyeshëm besojmë se i padituri e ka uzurpuar edhe një pjesë të paluajtshmerisë të paditësit të evidentuar si NK P-71611071-91 ZK P.’”. Tutje ka shtuar se në referatin e padisë mungojnë të dhënat e domosdoshme përkitazi me shtrirjen gjeografike të murit të ndërtuar nga i padituri në mes të dy paluajtshmerive përkufizuese të ndërgjyqësve. Në këtë çështje nuk ka arsye që të zbatohet dispozita e nenit 80 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, sepse nuk është dëmtuar vija përkufizuese në mes paluajtshmerive përkufizuese të ndërgjyqësve, apo dëmtimi, asgjësimi e të ngjashme të shenjave përkufizuese. Pretendimi nga referati i padisë se kinse nën ndërtimin e murit përkufizues nga i padituri, i njëjti e ka uzurpuar një pjesë të paluajtshmerisë së paditësit është i pasaktë, sepse paditësi është dashur që për këtë pretendim gjykatës ti ofroj prova bindëse dhe konsistente. Këtë aq me parë se me nenin 7, par.1 të LPK -së, shprehimisht është parashikuar se ‘palët kanë për detyrë që ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat i kontestojnë faktet e tilla’. Kërkesëpadija e paditësit nuk i përmban elementet themelore, për çka si e tillë është e pa përmbarueshme. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe ka shtuar se fillimisht paluajtshmeria e të paditurit si ngastër kadastrale me numër 1/97 ka qenë në pronësi të mikut të tij, përkatësisht të Sh. B. nga P,i cili këtë truall e ka blerë në vitin 1970. Pas kryerjes së luftës së fundit në Kosovë rreth vitev 2000-2002, ish pronari i paluajtshmerisë kontestuese, pra Sh. B. ka pasur për qëllim që të ndërtoj murin përkufizues në mes të paluajtshmerisë së tij si dhe paluajtshmerisë së paditësit. Sipas thënieve të Sh.it, paditësi nuk ka treguar interesim të marr pjesë në ndërtimin e murit, Sh. B. me investimet e veta financiare e ka ndërtuar murin si dhe gjatë ndërtimit të murit, ashtu edhe me vonë nuk ka pasur kurrfarë vërejtje as kundërshtime nga paditësi. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë të gjitha deklarimeve të dhëna si në përgjigje në padi ashtu edhe gjatë seancave të mbajtura sipas këtij kontesti, me qëllim të ekonomizimit të procedurës dhe efikasitetit të saj i autorizuari i të paditurit ka parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në sipërfaqe kontestuse prej 4 m², në menyrë që kjo padi e cila evidentohet nën shenjën C.nr.299/25 të trajtohet si kundërpadi dhe e njëjta ti bashkëngjitet padisë së paditësit C.nr.2731/21. Edhe pse në këtë seancë gjykata e refuzojë parashtrësën lidhur me pretendimet e theksuara me sipër të të autorizuarit të paditurit, konsideroj se ka pasur bazë juridike që padia me numër C.nr.299/25 të trajtohet si kundërpadi konekse dhe njëherit të vendoset edhe për këtë padi bazë e të cilit është vërtetimi i të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar të sepcifikuara.

III. Provat e administruara nga gjykata

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: Certifikata e pronës e datës 09.08.2021 me numër 818441, kopje e planit e datës 09.08.2021, kushtet e lokacionit të datës 21.11.2010 e lëshuar nga DUMM-P., aktvendimi i datës 10.02.2011 me numër 08-351/762 lëshuar nga DUMM në P., plani i situacionit i datës 04.06.2012, kopje e planit e datës 25.03.2011 për ngastrës 1-40, ekspertizë e gjeodezisë me numër C.nr.2731/21 e datës 06.11.2024 së bashku me skicën e matjes, certifikatën e pronës, fotografitë e vendit të ngjarjes, ortofoton, si dhe ka bërë dëgjimin e dëshmitarit Sh. B..

IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi është pronar i pjesës së ngastrës P-71611071-00001-91 ZK P. në sipërfaqe prej 350 m² fakt ky i pohuar nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse si dhe i provuar dhe përmes certifikatës së pronës të datës 08.10.2024 ZK P..

Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se i padituri është pronar i pjesës së ngastrës P-71611071-00001-97 ZK P. në sipërfaqe prej 200 m² fakt ky i pohuar nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqësore si dhe i provuar përmes certifikatës së pronës të datës 08.10.2024 ZK P..

Nuk ishte kontestuese fakti se pronat e ndërgjyqësve ishin parcela fqinje dhe kufizoheshin me njëra tjetrën.

Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se murin e ndërtuar në mes të njësisë kadastrale me numër 00001-91 dhe 00001-97, e ka ndërtuar Sh. B., i cili ka qenë pronar paraprak i parcelës 00001-97.

Kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse ishte nëse palës paditëse i takon e drejta që të kërkojë nga paditësi dorëzimin e sendit, konkretisht pjesës së ngastrës që është objekt shqyrtimi dhe nëse i padituri këtë pjesë e mban pa ndonjë bazë ligjore.

Nga administrimi i gjithmbarshëm i provave materiale dhe marrë për bazë faktet të cilat nuk ishin kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se parcela me numër 1-91 me pronar paditësin dhe 1-97 me pronar të paditurin, që të dyja në ZK P., janë parcela fqinje dhe kufizohen me njëra tjetrën, ku në vijën ndarëse në mes të këtyre dy parcelave, është i ndërtuar muri nga materiali i fortë (blloka të betonit) e i cili muri është i ndërtuar nga ish pronari paraprak i parcelës 1-97 (dëshmitari Sh. B.) në vitin 2001, ku pjesërisht ky muri shtrihet në parcelën e paditësit dhe i cili është i vendosur pa një marrëveshje paraprake në mes të fqinjëve. Tutje gjykata ka vërtetuar se i padituri, pa bazë ligjore është duke mbajtur një pjesë të parcelës së paditësit (pjesa e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit) andaj paditësit, i lind e drejta që nga personi (i padituri) që pa bazë ligjore është duke mbajtur një pjesë të pronës së tij, të kërkojë dorëzimin e sendit.

Përmes orto fotos për parcelat 1-91 dhe 1-97, gjykata vërtetoi faktin se në këto parcela në teren, në ngastrën kadastrale me nr. njësie 1-91 është e ndërtuar shtëpia e banimit e palës paditëse, dhe në ngastrën kadastrale me nr. njësie 1-97 është e ndërtuar shtëpi banimi e palës së paditur, kurse kur më pas ndërlihet me provat e tjera materiale si ekspertiza gjeodezike së bashku me skicën e matjes dhe ortofotot, vërtetohet se muri përkufizues është i ndërtuar pjesërisht në parcelën kadastrale me numër 00001-91 në pronësi të Sh. Sh. dhe atë në sipërfaqe prej 4 m², i cili është i ndërtuar gjegjësisht në anën veri-perëndimore të parcelës 00001-91, që është objekt kontesti.

Me qëllim të identifikimit dhe matjes së pjesës kontestuese, gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë të gjeodezisë dhe së bashku me ekspertin gjeodet D. K. dhe të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse ka dalë në vend shikim për identifikim dhe matje të pjesës kontestuese.

Eksperti gjeodet, me datë 06.11.2024, në gjykatë ka dorëzuar ekspertizën gjeodezike, sipas të cilës vërtetohet se parcela me numër 00001-91, me kulturë oborr, me sipërfaqe 350 m², evidentohet në emër të paditësit Sh.(Rr.) Sh.. Kjo parcelë në anën veriore përgjatë tërë shtrirjes së saj kufizohet me rrugën publike "H. T." si dhe Gjimnazin "B. P.", në anën jugore kufizohet me parcelën kadastrale me numër njësie 1-40 me pronar Sh. B., në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale me numër njësie 1-87, me pronar Komuna e P.s, në anën perëndimore

kufizohet me ngastrën kadastrale me numër njësie 00001-97, me pronar A. Q. L.këtu palë e paditur. Në terren në këtë parcelë është e ndërtuar shtëpia e banimit e tipit P+1K, e cila shtihet në anën veriore të parcelës. Kjo parcelë në të gjitha anët gjeografike është e rrethuar me muri dhe e mirëmbajtur mirë. Në anën perëndimore kufizohet me muri prej bllokave betoni në lartësi afërsisht në 1.50 cm mur ky që është i mbuluar me tjegulla (qeremnide). Po ashtu edhe në parcelën kadastrale me numër 00001-97 në kuadër të saj është e ndërtuar shtëpia e tipit B+P+2K+KT e rrethuar në të gjitha anët gjeografike të saj dhe është në posedim të palës së paditur.

Sa i përket pjesës e cila është objekt kontesti, pas incizimit dhe matjes të bërë në teren, muri faktik që pretendohet që është i ndërtuar nga ana e palës së paditur A. L., mur ky që ndan dy parcelat kadastrale (00001-91 dhe 00001-97 atë të palës paditëse dhe palës së paditur) në terren është i ndërtuar pjesërisht në parcelën kadastrale me nr.00001-91 në pronësi të Sh. Sh. atë në sipërfaqe prej $S=4m^2$ mur ky që është i ndërtuar gjegjësisht në anën veri-përendimore të parcelës 00001-91. Kjo sipërfaqe realizohet përmes këtyre pikave: nga pika e detajit nr.1 dhe A në gjerësi prej 0.45 cm që shkon në drejtim të jugut deri në pikën nr.2 e atë në gjatësi prej $D=16.98m$. Gjerësia në drejtim të jugut shkon duke u zbritur që varion në 0.30 cm, 0.25 cm, 0.10 cm e deri 0.00 cm (pika nr.2). Andaj sipërfaqja që është llogaritur prej $S=4m^2$ është e llogaritur brenda kufijve kadastral – pronë private të palës paditëse Sh. Sh..

Kësaj ekspertize, eksperti i ka bashkangjitur edhe skicën e matjes, përmes së cilës në mënyrë vizuale është paraqitur me ngjyrë të kuqe pjesa e të cilën pala e paditur e mban nga paditësi e që realizohet sipërfaqja prej 4 m². Më tutje, nga orto foto që është pjesë e kësaj ekspertize, vërehet se parcelat 00001-91 dhe 00001-97 janë parcela fqinje dhe të ngjitura me njëra tjetrën, në pjesën që është objekt i kontestit ka të ndërtuar objekt – shtëpi banimi që gjendet në pjesën e brendshme të parcelës 00001-91, në mesin e të dy parcelave ndodhet muri i ndërtuar prej bllokave të betonit në lartësi prej 2 metra, ku më së afërmi është paraqitur edhe përmes fotografive të bëra në vendin e ngjarjes, e përmes të cilave pra vërtetohet se në sipërfaqja prej 4 m² të cilën e mban i padituri pa bazë ligjore është i ndërtuar muri prej bllokave të betonit i cili shtrihet mes dy paluajtshmerive të palës paditëse dhe të paditur, e ku në ngastrën kadastrale me nr. njësie 00001-91 e cila është në pronësi të palës paditëse Sh. Sh. muri prek pjesën prej 4 m² e cila është e llogaritur brenda kufijve kadastral – pronë private e paditësit.

Gjykata i fali besimin e plotë kësaj ekspertizë gjeodezike, pasi që e njëjtë ka pasqyruar në tërësi gjendjen faktike, po ashtu edhe sipas konstatimit të gjykatës, e njëjta i përmban të gjitha elementet e nevojshme që duhet ti ketë një ekspertizë, e njëjta është dhënë mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertit të cilën gjykata e vlerësoi si të drejtë. Ekspertiza për më tepër ka në përmbajtje edhe certifikatën e pronës për ngastrën lëndore kontestuese, certifikatën e pronës për ngastrën fqinjë, përkatsisht të palës së paditur, ortofoton e kësaj ngastre për vitin si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

Gjykata konform nenit 362 të LPK-së, ka ftuar për sqarime ekspertin gjeodet, në seancën e datës 17.03.2025, pasi që pala e paditur kishte vërejtje në lidhje me ekspertizën e e punuar nga eksperti gjeodet, duke kërkuar sqarime plotësuese lidhur me sipërfaqen e kontaktuar prej 4 m² në pronësi të paditësit, eksperti ka deklaruar se qëndroj në tërësi pranë ekspertizës së përpiluar me datë 06.11.2024, nuk kam diçka tjetër për të shtuar përveç asaj që është thënë në ekspertizë, dhe se ashtu siç kam deklaruar në ekspertizë kjo është gjendja e fundit që evidentohet në kadastër. Në pyetjen e palës së paditur se ish pronari i parcelës 1-97 para vendosjes së murit ekzistues ka bërë matjet në mes parcelave përkufizuese, andaj si është e mundur që tani muri të jetë i vendosur pjesërisht në parcelën e paditësit, eksperti është përgjegjës se ditën e daljes në terren nuk ka pasur ndonjë shufër metalike të vendosur por pa varësisht kësaj kolegu i lartcekur nuk e di se me çfarë shënime (produkte) kadastrale është matur, nuk e di cila metodologji e punës është përdor (a është shfrytëzuar rrjeti poligonal apo është matur me sistemin e ri KOPOS, nëse është matje gjeodezike (poligonale) mund të ketë dallim mes matjes e sistemit GPS (KOPOS) andaj unë si ekspert gjeodet matjet janë realizuar me shënimet (produktet e fundit që janë në ZZK) duke shfrytëzuar sistemin e ri GPS (KOPOS) gjë që mbaj përgjegjësi për hartimin e ekspertizës dhe diferencën e cekur në ekspertizë. Ndërsa i autorizuar i palës paditës nuk kishte pyetje dhe as vërejtje në ekspertizë.

Me daljen në vendshiqim së bashku me ekspertin e gjeodezisë si dhe palët në procedurë, përveç nxjerrjes së provës me ekspertizë, gjykata ka bërë edhe vend shikimin, me ç' rast ka konstatuar se parcela kadastrale me numër 1-97 ZK P. në certifikatën e pronës evidentohet në emër të Sh. Rr. Sh. me sipërfaqe të përgjithshme prej 350 m², në kuadër të kësaj parcele është e ndërtuar shtëpi e banimit e tipit P+1K e materialit të fortë, kjo njësi në terren në të gjitha anët e saj gjeografike është e rrethuar me mur, pjesa që është objekt kontesti kufizohet me parcelën 1/97 që në certifikatën e pronës evidentohet në emër të A. Q. L.. Në terren parcelat e palës paditëse dhe të paditurit vija përkufizuese e tyre i ndan me muri prej bllokave të betonit në lartësi prej 2

metra. Objekti i cili konstatohet sipas palës paditëse është gjegjësisht në anën veriore të parcelës duke vazhduar në drejtim të jugut. Palët në procedurë, i autorizuari i paditësit dhe të paditurit, nuk kishin bërë vërejtje në konstatimin e gjendjes faktike në teren, të cilën e kishte konstatuar gjykata me ndihmën e ekspertit gjeodet D. K..

Gjykata, me propozimin e të autorizuarit të palës së paditur, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit Sh. B. në seancën e datës 11.10.2024, ku dëshmitari Sh. B., pasi që ishte njoftuar me të drejtat e tij nga neni 247 dhe 343 të LPK-së, ka deklaruar se: palët në procedurë, përkatësisht paditësin e ka fqinjë dhe të paditurin dhëndër, tutje ka shtuar se truallin që e ka në pronësi i padituri A. L., ka qenë i imi sepse dy ari të kësaj prone që tani është në emër të A.it i'a kam dhënë vajzës sime si hise ka rreth 10 vite, dhe murin që gjendet në mes të shtëpisë së A.it dhe Sh.it e kam ndërtuar personalisht që 20 vite dhe e kam ndërtuar në tokën time dhe paditësi Sh. ka qenë këtu duke jetuar, dhe kam biseduar me të dhe i kam thënë se dua ta ndërtoj murin dhe e kam pyetur se a dëshiron ta ndërtoj më së bashku sepse unë kam pas ta ndërtoj një garazhdë dhe se mund ti bashkëngjitet dhe me ka thënë jo, pastaj unë para ndërtimi të murit kam marr gjeodet i ka qit pikat dhe e kam ndërtuar murin në pikën time për këtë ekzistojnë dokumentet në kadastrë, muri pikën e ka në parcelën që ka qenë e imja. Tutje ka shtuar se Sh.i këtu paditësit nuk i ka propozuar që ai me ndërto murin, dhe se kur i ka vendosur pikat Sh.i nuk ka qenë prezent ka qenë rreth shtëpisë dhe nuk ka qenë i interesuar, dhe asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë bisede rreth këtij muri deri me tani.

Deklarimit të dëshmitarit gjykata i fali besimin pjesërishtë, pasi që deklarata e të njëjtit sa i përket ndërtimi të murit nga ana e tij e pasqyron gjendjen faktike, gjë që edhe nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse se muri ishte ndërtuar nga ana e tij në kohën kur ngastra kadastrale me numër 00001-97 ishte në pronësi të tij, e tani në pronësi të palës së paditur, e po ashtu i njëjti ishte edhe banor i vendit ku gjendej ngastra lëndore, pra ishte fqinjë i paditësit dhe pasi që palujatshmeria 00001-97 që gjendet në kufinjë me palujatshmerinë kontestuese kishte qenë e tij dhe muri ishte ndërtuar nga ai, i njëjti kishte njohuri lidhur me çështjen kontestuese. Gjykata nuk ja fali besimin pjesës së deklarimit të tij ku i njëjti pretendon që muri që është ndërtuar nga ai paraprakisht ka bërë matjet me ekspert gjeodet dhe muri është ndërtuar në pjesën që ka qenë e tij, me prezencën e ekspertit në seancë për sqarime i njëjti ka konstatuar lidhur me këtë pjesë se momentin e daljes në terren nuk kemi vërejtur ndonjë shufër metalike dhe se nuk ka njohuri se me çfarë shënime (produkte) kadastrale është matur, nuk e di cila metodologji e punës është përdor (a është shfrytëzuar rrjeti poligonal apo është matur me sistemin e ri KOPOS, nëse është

matje gjeodezike (poligonale) mund të ketë dallim mes matjes e sistemit GPS (KOPOS) andaj si ekspert gjeodet ka konstatuar se matjet janë realizuar me shënimet (produktet e fundit që janë në ZZK) duke shfrytëzuar sistemin e ri GPS (KOPOS). e ku përmes ekspertizës është konstatuar se muri përkufizues pjesërisht është i ndërtuar në ngastrën kadastrale objekt kontesti dhe atë në sipërfaqe prej 4 m² në kudër të ngastrës kadastrale me numër 1-91 që realizohet nga pika 1 e deri në pikën A në gjerësi prej 0.45 cm që shkon në drejtim të jugut e deri në pikën numër 2 dhe atë me gjatësi prej D-16.98 metra. Gjerësia në drejtim të jugut shkon duke u zbritur dhe varion prej 0.30 cm, 0.10 cm, deri 00 në pikën numër 2.

Gjykata, lidhur me të drejtën materiale të aplikueshme, në këtë rast ka përdorur dispozitat e Ligji Nr.03/L-154 Për Pronësinë Dhe Të Drejtat Tjera Sendore (më tutje LPDTS) dhe sa i përket pikës I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata në kuptim të të thënave më lartë, vendosi në këtë mënyrë, pasi që paditësi është pronar i pjesës kontestuese, andaj atij i rrjedhë e drejta për disponimin e lirë dhe të plotë të sendit sipas dëshirës së tij, e kjo e përcaktuar, sipas nenit 18 të LPDTS-së, *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”*. Duke qenë se në bazë të së drejtës pozitive, paditësi Sh. Sh. është pronar i pjesës ngastrës kadastrale 00001-91 ZK P. e vërtetuar përmes certifikatës së pronës dt. 08.10.2024(pjesë e ekspertizës gjeodezike), dhe se i padituri është duke e mbajtur në zotërimin këtë pjesë të ngastrës, gjykata vlerëson se në këtë rast, ai si pronar e ka të drejtën që të kërkojë nga mbajtësi, në këtë rast këtu i padituri, kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, e që në këtë rast është pjesa e ngastrës kadastrale 00001-91 ZK P., sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Në dispozitën e nenit 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, është parashikuar e drejta e pronarit të ta kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi *“Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”*, kështu i padituri është i detyruar që të bëjë dorëzimin e sendit tek pala paditëse, pasi që të njëjtin është duke e mbajtur pa asnjë bazë juridike.

Me këto prova të administruara gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I dhe II të këtij dispozitivi, gjë të cilën e vlerësoi si konstatim të drejtë, të ligjshëm dhe që i shërben qëllimit të kontestit, pasi që sipas provave të lartcekura vërtetohet se i padituri është duke e mbajtur pjesën e ngastrës kadastrale si në pikën II të këtij dispozitivit të këtij aktgjykimi pa asnjë bazë juridike dhe si të tilla gjykata i ka pranuar si të bazuara pretendimet e palës paditëse.

Sa i përket pretendimeve të të paditurit, gjykata nuk ka gjetur bazë për mbështetjen e pretendimeve të tilla dhe të njëjtat i konsideroi si të pabazuara. Kjo për faktin se në këtë procedurë kontestimore, vendimtare ishte fakti se cili nga palët ka në pronësi pjesën e ngastrës kontestuese dhe se kush është pronar i kësaj pjese të ngastrës. Gjykata me këtë rast vë theksin se në procedurë kontestimore vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve, bazuar në nenin 2.1 të LPK-së “*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*” ashtu që nga pala e paditur nuk kishim asnjë kërkesë, por vetëm prapësime të natyrës materiale. Pretendimi se pala paditëse nuk e ka kundërshtuar dhe kërkuar asnjëherë këtë pjesë të kësaj ngastre por dikur vonë, gjykata më këtë rast thekson se e drejta në pronë është e drejtë kushtetuese (neni 46 E drejta në Pronë i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) dhe e mbrojtur dhe me instrumente tjera ndërkombëtare (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet shtesë, neni 1 –Mbrotjtja e Pronës i protokollit shtesë) që përcakton “*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare*” dhe si e tillë nuk parashkruhet asnjëherë, andaj pronari i saj ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë realizimin e të drejtës së tij në raport me persona të tjerë të cilët i’a cenojnë pronësisë dhe disponimin e lirë të saj, pasi që është e drejtë absolute dhe vepron *erga omnes*. Kësisoj, sipas nenit 7 të LPDTS, të drejtat sendore nuk parashkruhen.

Gjykata gjithashtu ka administruar dhe vlerësuar edhe provat e bashkangjitura me përgjigje në padi nga pala e paditur, siç janë aktvendimi me numër 08-351/762 i datës 10.02.2011, planin e situacionit me numër 54/2012 i datës 04.06.2012, kopje e planit e datës 25.03.2011, mirëpo nuk u lëshua në arsyeshmërinë e tyre, sepse konsideroj se nuk ishin relevante dhe nuk do të ishin me ndikim për një vendim më ndryshe.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, e pala paditëse në këtë drejtim përmes certifikatës së pronës, ekspertizës gjeodezike, i ka provuar faktet mbi të cilat e ka pretenduar të drejtën e vet. Pra ka provuar se është pronar i pjesës së ngastrës kontestuese dhe se i padituri pa bazë ligjore është duke ia mbajtur këtë pjesë, e që

paraqiten si fakte vendimtare. I padituri në këtë drejtim, nuk ka ofruar prova materiale apo të tjera me qëllim që të provoj faktet me të cilat i ka mbështetur pretendimet e tij, por ashtu siç u tha, ka paraqitë vetëm prapësime materiale.

Gjykata, në kontekst të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, është e obliguar që të kufizohet në të provuarit e asaj që palët prezantojnë në gjykatë, e asesi nuk mundet të marrë rol aktiv për nxjerrje të provave, e me përjashtim në rastet e parapara me nenin 3.3 të LPK-së, ashtu që edhe gjendja faktike e vërtetuar, është në bazë të provave që palët i kanë prezantuar në gjykatë e me qëllim të vërtetimit të fakteve të pretenduara nga të njëjtit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449.1 dhe 452.1 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet dhe atë: për padi 78 euro, taksë për padi 21 euro, për katër seanca të mbajtura nga 101 euro për seancë, për ekspertizë gjeodezike shumë prej 300 euro e gjithsejtë 803 euro, të llogaritur sipas tarifës së OAK për kontestet me vlerë deri në 500 euro, pasi që këto janë shpenzime shpenzimet e krijuara në këtë procedurë, ndërsa pjesa tjetër refuzohet si e pa bazuar.

Në bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 7, 18, 93 të LPDTS-së dhe nenit 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE P.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:260846, C.nr.2731/21, Dt.21.03.2025

Gjyqtari
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.